# DËSHMI ARKIVI

**A-456136**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Vodafone sjell për herë të parë në Shqipëri WiFi7, teknologjinë mëtë avancuar për internetin në shtëpi |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/ekonomia/vodafone-sjell-per-here-te-pare-ne-shqiperi-wifi7-teknologjine-mete-ava-i586959` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 18:11:04 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 17:58:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b3e3aea3bc13ebd9226d95e3d9bbe855d066893e3f06b0853440314c4b96ed06` |
| TEKSTI | `3691cbbd361e39d1c4da78df5fe3a0ff6e92602a647cf6d8ea3845e5bf02fd94` |
| PAMJA | `e8cf8c0a5b258ed3d07dcc2933bbf05e55baa3c2c9075ffa6452f8a3e291f4dd` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `adcab598578327bf43ecde2a680d9a9ee88883e81d2a9a4992179d76fdbdb8bf` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `214493168e8eaddb39b9693f5adfa0b73b0dd908a9438af0217b4721b8b2f352` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/adcab598578327bf43ecde2a680d9a9ee88883e81d2a9a4992179d76fdbdb8bf`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Vodafone sjell për herë të parë në Shqipëri WiFi7, teknologjinë mëtë avancuar për internetin në shtëpi

TemA
18 Shtator 2026, 19:58Ekonomia TEMA




Vodafone Albania është operatori i parë që sjell Wi-Fi 7 për klientët në Shqipëri, duke vendosur gjeneratën më të fundit të teknologjisë Wi-Fi në zemër të Vodafone Fiber. Ndonëse në emërtim mund të tingëllojë si term teknik, në fakt përvoja e përdoruesit është shumë e thjeshtë: Internet më i shpejtë, më i qëndrueshëm dhe më i besueshëm, i përshtatur me mënyrën se si jetojmë dhe punojmë sot.

Dikur, interneti në shtëpi kishte një detyrë të vetme: të lidhte kompjuterin e familjes. Sot, ai duhet të mbajë online një shtëpi të tërë. Dikush është në një videokonferencë, një tjetër po sheh një film në rezolucion 4K, një adoleshent po luan online, ndërsa një pjesëtar tjetër i familjes po ngarkon një detyrë që, sigurisht, iu kujtua në minutën e fundit.

Wi-Fi 7 është krijuar pikërisht për këtë realitet. Pajisja e re Wi-Fi 7 e Vodafone ofron një eksperiencë Wi-Fi 20% më të shpejtë dhe deri në dyfishin e shpejtësisë përmes lidhjes me kabllo. Ajo mundëson gjithashtu lidhjen e më shumë pajisjeve njëkohësisht, pa rënien e cilësisë së shërbimit që mund të shoqërojë gjeneratën e mëparshme Wi-Fi 6.

Për gamers, adhuruesit e streaming-ut apo këdo që ka parë një koleg të “ngrijë” në ekran pikërisht në mes të një fjalie të rëndësishme, Wi-Fi 7 sjell deri në tre herë më pak vonesë në transmetimin e të dhënave. Teknologjia e avancuar Multi-Link Operation (MLO) krijon gjithashtu një lidhje më të qëndrueshme dhe të besueshme, duke u mundësuar pajisjeve të përdorin në mënyrë më efikase lidhjet Wi-Fi në dispozicion.

Me fjalë të thjeshta: më pak vonesa, streaming më i qetë dhe më pak thirrje nëpër shtëpi: “Kush po shkarkon diçka?!”

Por, rëndësia e Wi-Fi 7 shkon përtej argëtimit. Fëmijët mund të ndjekin mësimin online pa humbur mësuesin në mes të shpjegimit. Profesionistët mund të punojnë në distancë pa u ndier të shkëputur nga puna. Një biznes i vogël mund të përdorë shërbimet cloud, të zhvillojë takime me partnerë ndërkombëtarë dhe t'u shërbejë klientëve jashtë vendit, drejtpërdrejt nga zyra e tij në Tiranë.

Fibra optike është pjesë e infrastrukturës së një ekonomie moderne. Zhvillimi nuk është vetëm infrastruktura e madhe që shohim përreth nesh, rrugët, aeroportet apo ndërtesat e reja. Ai nis edhe në një zyrë shtëpie, gjatë një videotelefonate që nuk ndërpritet, apo në momentin kur një ide lokale arrin te një klient ndërkombëtar.

Dhe kur ndodh e papritura, Vodafone Fiber ka një tjetër përgjigje: Always Connected.

Nëse punimet në zonë apo një incident tjetër dëmtojnë linjën e fibrës, shërbimi kalon automatikisht në rrjetin celular të Vodafone. Kështu, shtëpitë dhe bizneset vazhdojnë të qëndrojnë online, pa qenë nevoja që përdoruesit të kthehen vetë në "asistencë teknike".

Sepse Wi-Fi më i mirë është ai për të cilin pothuajse nuk duhet të mendosh fare. Takimet ndryshojnë, afatet afrohen dhe ndonjëherë dita vendos të dalë krejtësisht jashtë planit. Vodafone Fiber, fuqizuar nga Wi-Fi 7, ecën me ritmin tënd, ndërsa Always Connected kujdeset që lidhja të mos të lërë në baltë.

Zbuloni #tëparëtWiFi7 nga Vodafone Albania, internet që nuk të lë në baltë.

Eksploro Vodafone Fiber | Shiko spotin e ri të Vodafone

---


## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Malaj: Po analizojmë marzhet e çmimeve - MF kërkon të identifikojë hapësirat për ndërhyrje fiskale në lehtësim të konsumatorëve

16:50 Ekonomia / 1 koment

"Kemi çmimet më të larta në rajon", Ibrahimaj: Prisnim ulje të kostove të produkteve pas forcimit të lekut

16:00 Ekonomia / 6 komente

Rruga Kombinat - Plepa: Shpallet fituesi për segmentin 4.9 km, oferta 765.5 mln lekë

15:20 Ekonomia / 5 komente




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.